



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Uprava za Poleprivrednu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 3380 Më 03.09.2020  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

# THIRRJE PËR APLIKIM

Përkatje e fermerëve me Komore Ftohëse dhe  
Laktofriz

Rahovec, Shtator 2020

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL FTON TË GJITHË FERMERËT E KOMUNËS SE RAHOVECIT QË TË APLIKOJNË PËR PAJISJE QË SHËRBEJNË PËR RUAJTJE TË PRODUKTEVE BUJQËSORE

**• Sektorët të cilët do të përkrahen përmes kësaj thirrje janë:**

1. Pemëtaria (vreshtaria),
2. Perimekultura,
3. Blegtoria.

**Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e grantit janë:**

- Të jenë banor të Komunës së Rahovecit,
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF)
- Të kenë të shlyera obligimet ndaj Komunës,
- Të jetë i gatshëm / e gatshme te nënshkruan kontratë me kushtet e Komunës
- Të posedojnë tokë bujqësore në pronësi apo të marr me qira,
- Të mos jetë përfitues i granteve komunale në tre vitet e fundit,
- Të jetë i gatshëm të financoj 20% të vlerës së pajisjes,

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**

- Aplikacioni (merret online ose në zyrat e DBPZHR-së),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Dëshmi mbi pronësi të tokës bujqësore,
- Vërtetim mbi shlyerjen e obligimeve ndaj Komunës së Rahovecit ( Tatim në pronë dhe taksë komunale ).

**1. Komore ftohëse  $V=25 \text{ m}^3$**

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë fermerë/fermër, kultivues i kulturave pemëtare dhe perimore.
- Të ketë të mbjellë pemë drufrutore (Kumbullë, Mollë, Dardhë, etj) së paku 1 ha
- Të ketë të mbjellë bimë të imëta (Dredhëz, Manaferra, Mqedër) së paku 1 ha
- Të ketë të mbjellë së paku 3 ha me perime (Specë, Domate, Qepë)
- Të ketë të mbjellë së paku 3 ha me vreshta
- Të ketë të regjistruar biznes që merret me përpunim të perimeve ( Ajvar dhe Turshi )
- Të jetë i licencuar për prodhimin e fidanëve të hardhisë së rrushit dhe pemëve drufrutore.

**2. Komore ftohëse  $V=40 \text{ m}^3$**

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë fermer/fermerë, kultivues i kulturave pemëtare dhe perimore.
- Të ketë të mbjellë së paku 5 ha me vreshta apo 5 ha me perime
- Të jetë biznes i regjistruar që merret me përpunimin e perimeve dhe që eksportojnë produkte (së paku dëshmi DUD doganor gjatë vitit 2019)

**3. Laktofriz 300 L**

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë fermer blegtor që posedon, Lopë qumështore, dele dhe dhi
- Të ketë lopë qumështore nga 8 deri 20 krerë
- Të ketë së paku 150 krerë dele
- Të ketë së paku 50 krerë dhi

Dëshmi nga veterinari i licencuar nga AUV.

**4. Laktofriz 500 L**

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë fermer blegtor që posedon, Lopë qumështore, dele dhe dhi
- Të ketë lopë qumështore nga 21 deri 50 krerë
- Të ketë së paku 300 krerë dele
- Të ketë së paku 150 krerë dhi

Dëshmi nga veterinari i licencuar nga AUV .

**Vërejtje:**

- *Përqindja e përkrahjes do të jetë 80% nga Komuna e Rahovecit dhe 20% nga fermeri,*
- *Pasi të shpallen përfituesit, të gjithë fermerët janë të obliguar që ta kryejnë participimin prej 20% dhe të nënshkruajnë kontratën me Komunën e Rahoveci.*
- *Për specifikat e pajisjes fermerët do të informohen gjatë procesit të aplikimit.*

Afati i aplikimit nga data: **03.09.2020** deri më **18.09.2020**

Aplikacionet dorëzohen në drejtorinë e BPZHR-së, në objektin e vjetër të komunës së Rahovecit.